



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 13749 Prot

Lezhë, më 01 / 09 /2023

VENDIM

Nr. 34, Datë 30. 08. 2023

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË, NR.120  
DATË 02.12.2022 “PËR MIRATIMIN E BUXHETIT PËR VITIN 2023 DHE TË  
PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2023-2025”**

Në mbështetje të ligjit nr.139 /2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” , neni 8, pika 2, neni 54 gërma ç, dhe “dh”, ligjit Nr.68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore, të ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 “ Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr.9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë, Vendimit të Këshillit të Bashkisë Lezhë nr.120, datë 02.12.2022 “Për miratimin e buxhetit për viti 2023 dhe të programit buxhetor afatmesëm 2023-2025”, shkresës nr.11264 prot., datë 31.07.2023, me lëndë “Kërkesë”, të Drejtorisë së Shërbimit dhe Kujdesit Social”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

VENDOSI:

1. Miratimin e një shtesë në pikën 4, “Miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë Lezhë dhe institucioneve të varësisë 2023”, të VKB-së Nr.120 datë 02.12.2022 “Për miratimin e buxhetit për vitin 2023 dhe të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025” konkretisht si më poshtë:
  - 1.1 Shtohet numri i punonjësve në programin buxhetor si më poshtë:
    - Në programin buxhetor “10430”, “Përkujdesja Sociale”, shtohen 3 (tre) punonjës.
  2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
  3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI  
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI  
NDUE LULI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË  
SEKTORI JURIDIK

Prot 13749/  
Dt. 8.9.23.

ICB

Nr. 685/ Prot.  
21

Lezhë, më 06 .09 .2023

Lënda: Konfirmim vendimi

KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

Për Dijeni : KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË

Bazuar në nenin 16, pika 2, gërma "b" të ligjit nr.107, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", në nenin 54, gërma "ç" dhe "dh" të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", në ligjin nr.68, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", në ligjin nr.9936, datë 26.08.2008 "Për menagjimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, në udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit" konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr.34, datë 30.08.2023, të këshillit të bashkisë Lezhë "Për një shtesë në vendimin e këshillit të bashkisë Lezhë, nr.120, datë 02.12.2022 "Për miratimin e buxhetit për vitin 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm 2023-2025".

P R E F E K T I

Gjergj PRENDI

